Nexhmije Mehmetaj
Rizah Sheqiri

Përgatitja parashkollore

# PARAABETARE

EMRI DHE MBIEMRI:

KLASA

SHKOLLA

VENDI

SHTETI

dukagjini



ISBN 978-9951-05-236-8

Nexhmije Mehmetaj, Rizah Sheqiri

# Paraabetare

Fletore tematike
Zana dhe Iliri mësojnë shqip
PËRGATITJA PARASHKOLLORE

dukagjini

**MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË E KOSOVËS**

TEKSTE MËSIMORE PËR SHKOLLËN SHQIPE TË MËSIMIT PLOTËSUES NË DIASPORË

Autorë/e:
Besa Luzha, Hazir Mehmeti, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti-Metis, Nexhat Maloku, Nexhmije Mehmetaj, Rifat Hamiti, Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj, Xhevat Syla.

Hartues të këtij teksti: Nexhmije Mehmetaj, Rizah Sheqiri

Koordinatorë: Arif Demolli, Basil Schader, Nuhi Gashi

Projekti është mbështetur nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut (Instituti IPE -International Projects in Education) dhe Fondi i Llotarisë i Cyrihut (Lotteriefonds des Kantons Zürich) në Zvicër.

PH Zürich

LOTTERIEFONDS KANTON ZÜRICH

PËRMBAJTJA

1. Përshëndetje . . . . 5
2. Kush janë Zana dhe Iliri . . . . 6
3. Familja e Zanës dhe e Ilirit . . . . 7
4. Shokët e Zanës dhe të Ilirit . . . . 8
5. Çka hanë Zana dhe Iliri? . . . . 9
6. Lulet në kopsht . . . . 10
7. Fëmijët dhe flutura . . . . 11
8. Zana dhe Iliri ngjyrosin . . . . 12
9. Në qytet . . . . 13
10. Rrobat dhe lodrat . . . . 14
11. Stinët e vitit . . . . 15
12. Pemët . . . . 16
13. Perimet . . . . 17
14. Ku është ai . . . . 18
15. Në fshat . . . . 19
16. Vendi i shqiptarëve . . . . 20
17. Ngjyrat e flamurit . . . . 21
18. Në pyll . . . . 22
19. Në cirk . . . . 23
20. Çka u mungon këtyre vizatimeve . . . . 24
21. Në pushime dimërore . . . . 25
22. Insektet . . . . 26
23. Në dyqan . . . . 27
24. Në ditëlindje . . . . 28
25. Bashkësia . . . . 29
26. Fjalë me tingullin i apo a . . . . 30
27. Fjalë me tingull të njëjtë 1 . . . . 31
28. Fjalë me tingull të njëjtë 2 . . . . 32
29. Fjalë me tingullin M apo N . . . . 33
30. Fjalë e re . . . . 34
31. Fjalë që mbarojnë me tingull të njëjtë 1 . . . . 35
32. Fjalë që mbaronjnë me tingull të njëjtë 2 . . . . 36
33. Fjalë që fillojnë me r . . . . 37
34. Zëra të kafshëve . . . . 38
35. Fjalë e gjatë apo e shkurtër 1 . . . . 39
36. Fjalë e gjatë apo e shkurtër 2 . . . . 40
37. Fjalë e gjatë, e mesme e shkurtër . . . . 41
38. Më pak, më shumë, barabar . . . . 42
39. Fëmijët pranë kompjuterit . . . . 43
40. Në Durrës . . . . 44



# 1. Përshëndetje

| | |
|---|---|
| Mirëdita, mirëdita!<br>Si jeni? | *shqip* |
| Hello, hello!<br>How are you? | *anglisht* |
| Bonjour, bonjour!<br>Comment allez-vous? | *frëngjisht* |
| Hyvää päivää, hyvää päivää !<br>Mitä kuuluu te? | *finlandisht* |
| Γεια σας Γεια σας !<br>τι κάνετε? | *greqisht* |
| Ciao,  ciao !<br>Come stai? | *italisht* |
| Hei, hei<br>Hvordan går? | *norvegjisht* |
| Guten Tag, guten Tag!<br>Wie geht es euch? | *gjermanisht* |
| God dag, god dag !<br>Hur mår ni? | *suedisht* |

## 2. Kush janë Zana dhe Iliri?

Zana dhe Iliri janë motër e vëlla. Ata janë binjakë. Atyre u pëlqen vendi ku jetojnë. Aty kanë zënë shumë shoqe e shokë. Por dëshirojnë ta vizitojnë edhe fshatin e vogël Drelaj.

– Nënë, baba, do të shkojmë për pushime në Drelaj? – pyetën.

– Po, po, – u përgjigjën prindërit. Do ta shëtisim krejt Kosovën.

– Sa mirë! – u gëzuan fëmijët.



Unë jam Zana



Unë jam Iliri

a. Trego çka bëjnë Zana dhe Iliri.



b. Kopjo trenin, kujdes ndryshimet.



# 3. Familja e Zanës dhe e Ilirit

Familja e Zanës dhe e Ilirit jeton në ________________________________.

Në kopshtin shkollor ata mësojnë gjuhën__________________________________.

Në shtëpi flasin shqip. Pushimet i kalojnë në atdheun e prindërve të tyre. Gjyshi dhe gjyshja u tregojnë përralla interesante. Kështu ata nuk e harrojnë gjuhën e të parëve.




Familja ime

Vizato familjen tënde.

# 4. Shokët e Zanës dhe të Ilirit

Dilani dhe Klodi janë shokë të Zanës dhe të Ilirit.

Ata banojnë në të njëjtën ndërtesë...

Dilani dhe Klodi janë ________________________________________________.

Ata flasin gjuhën ____________________________________________________.

Gjatë kohës së lirë ata luajnë bashkë në oborrin e ndërtesës. Me njëri-tjetrin flasin ________________________________________________________________.

a. Lidh me një vijë. Dilani




b. Labirinti. Loja fshehtas.

Cilën rrugë duhet të marrë Klodi për t'i gjetur shokët?



# 5. Çka hanë Zana dhe Iliri?

a. Shqipto saktë dhe me zë të lartë emrat e këtyre figurave.
b. Lidh me vijë ushqimet që i hanë Zana dhe Iliri.



c. Çka han ti?

| Në mëngjes | Në drekë | Në darkë |
|---|---|---|
| | | |

ç. Vizato mjetet me të cilat hamë dhe pimë! (Pjatë, lugë, thikë, pirun, gotë.)

# 6. Lulet në kopsht

Zana dhe Iliri kaluan pranë një kopshti. Aty panë lloj-lloj lulesh. Zanës i pëlqenin lulet e kuqe. Ndërsa Ilirit lulet e kaltra. Secili e vizatoi lulen që i pëlqente.

**Ngjyros me ngjyrë të kuqe**



**Ngjyros me ngjyrë të kaltër**





# 7. Fëmijët dhe flutura

Fëmijët luanin në oborrin e shtëpisë. Fluturoi një flutur. Ajo u ndal në një lule të vogël. Ata donin ta kapnin fluturën. U afruan duke kënduar. "Flutur, flutur ba-bare, bjer përdhe." Flutura iku në një lule tjetër.

**Ngjyros me ngjyrë**

**të kaltërt**



**të verdhë**



**të kuqe**





# 8. Zana dhe Iliri ngjyrosin

– Zanë, e bëre detyrën e vizatimit? – pyeti Iliri.

– Po, Ilir, e bëra. E ngjyrosa të kuq miun e parë, të kaltër miun e dytë, të verdhë miun e tretë, të gjelbër miun e katërt, – u përgjigj Zana.

– Edhe unë Zanë do t'i ngjyros ashtu, – tha Iliri.

**Ngjyros me ngjyrë**

**të kuqe** **të kaltër** **të verdhë** **të gjelbërt**





# 9. Në qytet

Zana dhe Iliri banojnë në qytet. Ata shohin çdo ditë në rrugë xhaxhi policin. Ai drejton trafikun. Edhe fëmijëve u tregon se si duhet të ecin në rrugë. Ai këshillon:

– Shiko majtas, shiko djathtas, pastaj kalo rrugën.

**Ngjyros me ngjyrë**

**të kuqe policët që tregojnë majtas,** **të kaltër policët që tregojnë djathtas.**





# 10. Rrobat dhe lodrat

Zana dhe Iliri janë në dhomë. Aty ka dy kuti. Njëra është për rroba, kurse tjetra për lodra. Ata, në kohën e lirë, rregullojnë dhomën.

a. Thuaj me zë emrat e rrobave dhe të lodrave. Në cilën kuti i vendos rrobat dhe në cilën kuti lodrat.



b. Zbukuro veshmbathjet e Zanës dhe të Ilirit. Shiko mirë modelin.



# 11. Stinët e vitit

Cili vizatim i përgjigjet stinës së pranverës, verës, vjeshtës dhe dimrit? Trego si janë veshur fëmijët në çdo stinë!



Ngjyros stinët me ngjyra përkatëse.



.................................................... ....................................................





.................................................... ....................................................



.................................................... ....................................................

# 12. Pemët

Shqipto saktë emrat e pemëve
















b. Vizato pemët që të pëlqejnë më shumë.

# 13. Perimet

a. Shqipto me zë të lartë emrat e këtyre perimeve.














b. Vizato pesë perime.

| Karotë | Trangull | Qepë | Bizele | Lakër |
|---|---|---|---|---|

# 14. Ku është ai?

a. Përshkruaj saktë ku gjendet djali shakaxhi: afër, mbi, jashtë, në, përpara, prapa.



b. Përshkruaj saktë ku është kukulla.



# 15. Në fshat

Zana e Iliri shkuan në fshat. Atje panë kafshë dhe shpezë të ndryshme. Ata bënë gara kush dinte më shumë emra kafshësh dhe shpezësh.



Ngjyros me ngjyra të ndryshme këto figura.



# 16. Vendi i shqiptarëve

Ne jemi shqiptarë. Vendi i shqiptarëve quhet Shqipëri. Trojet e shqiptarëve dikur quheshin Iliri. Më vonë Arbëri. Të tjerët e quajnë Albania. Në kohën tonë shqiptarët jetojnë edhe në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi etj. Qytetet më të mëdha me shqiptarë janë Tirana, Prishtina, Shkupi, Ulqini e tjera. Vendi i shqiptarëve ka shumë male, fusha, dete dhe liqene.

a. Shiko me vëmendje këto pamje.

Ngjyros malet me ngjyrë kafe.

Fushat me ngjyrë të gjelbër

Detin dhe liqenet të kaltër



# 17. Ngjyrat e flamurit

Flamuri kombëtar shqiptar është kuqezi. E kuqe është fusha, e zezë është shqiponja.

a. Qarko nga 2 flamuj kuqezi.



b. Ngjyros flamurin shqiptar.



# 18. Në pyll

– Sa drunj të mëdhenj! – u habit Iliri.
– Sa drunj të bukur! - tha Zana.
– Dhe sa të shëndetshëm që janë! – tha nëna e tyre.
– Prandaj të shëtisim në ajër të pastër! – i ftoi babai.

Gjatë shëtitjes panë edhe disa kafshë.
Të gjithë u kënaqën shumë.
Shqipto saktë emrat e këtyre kafshëve të pyllit.

a. Ngjyros vizatimet sipas dëshirës.



b. Rretho çdo herë figurat që kanë këtë renditje.





# 19. Në cirk

– Doni të vini në cirk? – pyeti babai.

– Si nuk duam?! – u gëzuan fëmijët.

Nxituan të bëheshin gati. Shfaqja ishte e mrekullueshme. Zana dhe Iliri qeshnin me gjithë zemër.

– Rrobat e palaços janë me katrorë dhe trekëndësha, – tha Zana.

– Sa shumë lara që kanë, – u pajtua Iliri.

a. Ngjyros kostumin e palaços: **të kuq, të gjelbër, të verdhë.**



a. Flluska sapuni. Vazhdo vizatimin.



# 20. Çka u mungon këtyre vizatimeve?

Çdo vizatimi i mungon diçka. Gjeje çka mungon! Pastaj vizato me ngjyrë atë që mungon. Plotësoje vizatimin!



# 21. Në pushime dimërore

Zana dhe Iliri erdhën në fshatin e gjyshit të tyre.
– Sa më gëzuat që erdhët! – i përqafoi ai.
Gjyshja bëri një drekë të veçantë.
Në fshat kishte shumë borë. Fëmijët rrëshqitën me saj dhe me ski
Bënë shumë fotografi. Albumin do t'ua tregonin shokëve dhe shoqeve të tyre.
– Le ta shohin sa bukuri ka vendi i të parëve tanë, – thanë ata..
Lidh: Nëpër cilin shteg kaluan Zana dhe Iliri?



# 22. Insektet

Shqipto me zë të lartë emrat e insekteve:
**grerëz, mollëkuqe, flutur, bletë, pilivesë.**

a. Rretho me ngjyrë të njëjtë insektet e njëjta!



b. Ngjyros me ngjyrë portokalli fluturat mbi lule.



# 23. Në dyqan

## I madh- i vogël

Gjyshja i çoi Zanën dhe Ilirin në dyqanin e lodrave. Ajo u tha:

– Zgjidhni dy lodrat që ju pëlqejnë?
– Unë po marr dy gjirafa të mëdha, – tha Iliri.
– Unë po marr dy gjirafa të vogla, – tha Zana.

a. Cilat lodra i mori Zana dhe cilat Iliri?



Bashko pikat, vizato trupin e gjirafës me lara.



# 24. Në ditëlindje

Sot është ditë e hënë, Zana dhe Iliri kanë ditëlindjen. Në shtëpinë e tyre kanë ardhur djem dhe vajza të klasës: Xhoi, Kevin, Jennifer, Nolan, Flori. Ata urojnë: Gëzuar Zana! Gëzuar Ilir! Të gjithë kënduan këngën e ditëlindjes:

Shumë urime për ty!
Shumë urime për ty!
Shumë urime për ty, Zana!
Shumë urime, Ilir!

Happy birthday to you!
Happy birthday to you!
Happy birthday, dear Zana!
Happy birthday, Ilir!





a. Zanës i dhuruan
një qafore për ditëlindje.



b.Vizato dhe ngjyros
një qafore të njëjtë.

c. Ilirit i dhuruan
për ditëlindje një fyell.



d. Vizato edhe ti
një fyell të njëjtë.

# 25. Bashkësia

a. Në çdo kuti numëro saktë figurat.

b. Lidh numrin me figurën përkatëse.









5 6 1 8 4 2 3 7









5 6 1 8 4 2 3 7

c. Shqipto saktë emrat e figurave.

Ç. Rretho përgjigjen e saktë.



2 4 6 5 6 4



2 4 6 5 6 4



5 7 3 9 8 10



5 7 3 9 8 10

# 26. Fjalë me tingullin i apo a

Thuaj me zë të lartë emrat e figurave. Ngjyros të kuqe figurat ku e dëgjon tingullin i.

Ngjyros me ngjyrë të kaltër të gjitha figurat ku dëgjoni një a.



# 27. Fjalë me tingull të njëjtë (1)

Shqipto me zë të lartë emrat e figurave. Pastaj ngjyros figurat që fillojnë me tingull sikur ai i figurës së parë.



## 28. Fjalë me tingull të njëjtë (2)

Shqipto me zë të lartë emrat e këtyre figurave. Pastaj ngjyros me ngjyrë të kuqe figurat emrat e të cilëve fillojnë me të njëjtin tingull si ai i figurës së parë.



# 29. Fjalë me tingullin m apo n

Shqipto saktë emrat e figurave. Nëse fjala fillon me tingullin m, vë një + të kuq. Nëse fjala fillon me tingullin n, vë një + të kaltër.



## 30. Fjalë e re

Shqipto saktë emrat e figurave. Nga tingujt e parë të figurave mund të formosh një fjalë të re. Vizato atë figurë.



# 31. Fjalë që mbarojnë me tingull të njëjtë (1)

Shqipto me zë të lartë emrat e këtyre figurave. Kërko fjalët **që mbarojnë me tingull si emrat e figurës së parë**.

Ngjyros ato.



# 32. Fjalë që mbarojnë me tingull të njëjtë (2)

Shqipto me zë të lartë emrat e këtyre figurave. Kërko fjalët që mbarojnë me tingull si emrat e figurës së parë.

Ngjyros këto figura.



# 33. Fjalë që fillojnë apo mbarojnë me r

Shqipto me zë të lartë emrat e figurave. Ngjyros me të kuqe figurat, emrat e së cilave fillojnë me tingullin r. Ngjyros me të kaltër figurat, emrat e së cilave mbarojnë me tingullin r.























# 34. Zëra të kafshëve

Shqipto më zë të lartë emrat e këtyre kafshëve. Imito zërat e tyre.



Mjau- mjau- mjau



Ciu -ciu –ciu



Ga-ga-ga



Ki-ki-ri-ku



Ko-ko-ko



Iiaa-iaa-iaa



Ham- ham-ham



Hi- hi- hi



Muu- muu- muu



Be-be-be



Vrrauh- vrrauh- vrrauh.



Hu–hu-hu

# 35. Fjalë e gjatë apo e shkurtër (1)

Shqipto me zë të lartë emrat e këtyre figurave!

Nëse fjala është e gjatë, ngjyros vijën e gjatë; nëse fjala është e shkurtër ngjyros vijën e shkurtër.

| | | | |
|---|---|---|---|
|  (__________) |  (__________) |  (__________) |  (__________) |
|  (__________) |  (__________) |  (__________) |  (__________) |
|  (__________) |  (__________) |  (__________) |  (__________) |
|  (__________) |  (__________) |  (__________) |  (__________) |
|  (__________) |  (__________) |  (__________) |  (__________) |
|  (__________) |  (__________) |  (__________) |  (__________) |

# 36. Fjalë e gjatë apo e shkurtër (2)

a. Shqipto me zë të lartë emrat e këtyre figurave!

b. Ngjyros vizatimet sipas gjatësisë së fjalëve që emërtojnë këto vizatime.



# 37. Fjalë e gjatë, e mesme, e shkurtër

Në secilën radhë vizatimesh ngjyros: fjalën e gjatë që emërton figurën me ngjyrë të kuqe, fjalën e mesme me ngjyrë të kaltër dhe fjalën e shkurtër me ngjyrë të gjelbër.



## 38. Më pak, më shumë, barabar

Vizato, fshij, apo ndaj.

**Vizato edhe 2 topa të tjerë.**



**Fshij 4 dardha**



**Ndaji peshqit në dy grupe të barabarta.**



**Vizato edhe tri kërpudha të tjera.**



**Vizato edhe kaq lule.**



**Fshij 2 breshka.**



**Ndaji në 3 grupe**



# 39. Fëmijët pranë kompjuterit

Fëmijë janë ulur pranë kompjuterit. Mësuesja u shpjegon atyre si punohet me kompjuter. Ata dëgjojnë me vëmendje. Puna me kompjuter u pëlqen shumë. Ata bëjnë gara kush po punon më shpejt dhe më mirë.

**a. Thuaj më zë emrat e pjesëve të kompjuterit që shihni në vizatim**





b. Me kompjuter dëgjojmë muzikë shqipe.



**Kënga "Moj zoge"**



# 40. Në Durrës

Për çdo verë, Zana me Ilirin shkojnë në Durrës për pushime. Gjyshi i tyre Dini është peshkatar i vjetër. Ai çdo ditë zgjohet herët. Me Zanën dhe Ilirin shkojnë në det. Hipin në barkë. Gjyshi lëshon grepin. Valët e detit e tundin barkën. Kur bie peshku në grep, tundet edhe peri i shkopit të grepit. Zanës dhe Ilirit u vjen keq për peshqit e zënë. Gjyshi ua heq grepin nga goja dhe i lëshon prapë në det. Ai është një plak zemërbardhë. Peshkimin e bën vetëm për sport.

Kur të ngrohet, dalin në breg e shtrihen në rërë. Gjyshi është edhe notues i mirë. Nipi dhe mbesa mësojnë nga ai si notohet pa u lodhur shumë.

Emërto figurat dhe shqipto saktë:

**peshk, peshkaqen, delfin, karkalec deti,**
**breshkë deti, guacë, meduzë, yll deti, bretkosë.**



b. Shiko me vëmendje. Në akuarium janë disa peshq. Gjeji dhe ngjyrosi.







Nexhmije Mehmetaj, Rizah Sheqiri
**PARAABETARE**
**Fletore tematike**

Botimi i parë

Botues:
*Shtëpia botuese "DUKAGJINI" - Pejë*

Për botuesin:
*Agim Lluka*

Redaktor teknik:
*Lavdim Beqiri*

Tirazhi: *5.000 kopje*
*Formati: 205x285*

U shtyp në shtator 2010
në shtypshkronjën "Dukagjini" - Pejë
www.dukagjinigroup.com

Katalogimi në botim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

37.016:811.18(076.1)

Mehmetaj, Nexhmije
Fletore tematike: paraabetare Zana dhe Iliri mësojnë shqip: përgatitja parashkollore / Nexhmije Mehmetaj, Rizah Sheqiri - Pejë: Dukagjini, 2010. - 48 f. ilustr. me ngjyra; 30 cm.

**ISBN: 978-9951-05-236-8**

*Lejohet për botim me vendim të Ministrisë së Arsimit,*
*të Shkencës dhe të Teknologjisë të Kosovës, nr 292/2, të datës 22.06.2010*